



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**  
**MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË**  
**SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA**



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika (d), lidhur me nenin 40 paragrafi 2, pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 45 paragrafi 4, lidhur me nenin 46 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-048, për menaxhimin e financave publike të përgjithshme, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008”, e konform nenit 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 26.02.2026 miratoi këtë;

**V E N D I M**

**Neni 1**

Me këtë vendim miratohet raporti financiar i ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2025.

**Neni 2**

Pjesë përbërës e këtij vendimi është edhe raporti financiar i ekzekutimit dhe i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2025, me numër të protokollit 01-Nr-052-7017, të datës 09.02.2026, i hartuar nga Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet e Komunës së Suharekës.

**Neni 3**

Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoret e Drejtorive dhe Kryetari i Komunës së Suharekës.

**Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**

01-Nr- 016-9868  
Me datë 27.02.2026



Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI